

## Mbi pjesëmarrjen e KLSH-së në Fellowship-in e Government Accountability Office (GAO) në Washington DC 2024

KLSH mori pjesë në International Auditor Fellowship Program e organizuar nga Government Accountability Office (GAO) në Washington DC gjatë periudhës 17 prill 2024 deri më 12 korrik 2024 dhe u përfaqësua nga z. Rigels Guzi, auditues pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit. Angazhimi në këtë aktivitet që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve supreme të auditimit në të gjithë botën, u mundësua pas procesit konkurrues të përzgjedhjes për thellimin e njohurive në temën e propozuar *“Auditimi i mashtrimit, shpërdorimit dhe abuzimit, si dhe përdorimi i analizës së të dhënave si shembull i praktikave më të mira”*.



Në këtë sipërmarrje të Government Accountability Office ishin pjesëmarrës edhe institucione të tjera supreme të auditimit nga vende të tjera të botës dhe grupi që u angazhua në këtë eksperiencë përfshinte përfaqësues nga 16 shtete të tjera (Brazil, India, Kosova etj.). Rritja e kapaciteteve audituese ishte planifikuar të realizohej nëpërmjet një programi intensiv trajnimi të ofruar nga drejtuesit kryesorë të Government Accountability Office në fusha që përfshinin që nga lidhshirëpi dhe menaxhimi i ndryshimit, e deri në shembuj konkretë të procesit të angazhimit auditues në GAO. Ndarja e eksperiencave nga drejtuesit me përvojë të gjatë në fushën e auditimit publik e kombinuar me zhvillimet më të fundit në rolin e institucioneve supreme të auditimit nëpërmjet INTOSAI-t ishin ndër përfitimet më të mëdha për të implementuar ndryshim nga institucionet që përfaqësoheshin në program.

Fellowship përfshinte ndër të tjera edhe hartimin e një punimi strategjik në temën e propozuar për pjesëmarrje gjatë konkurimit. Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj eksperience, realizimi i këtij punimi u udhëhoq nga mentorë në nivel drejtues në GAO, të cilët rishikonin dhe jepnin sugjerime në drejtim të përmirësimit të strategjisë sipas kontekstit në të cilin institucioni suprem i auditimit

vepronte. Në përfundim, strategjia e propozuar u miratua nga udhëheqësi i punës dhe u mundësua pjesëmarrja në ceremoninë e diplomimit të organizuar për këtë rast, gjatë së cilës u zhvillua edhe një takim me Kontrollorin e Përgjithshëm të GAO, z. Gene Dodaro.



Me qëllim rritjen e partneriteteve dhe njëkohsisht ndarjen e praktikave më të mira në drejtim të forcimit të rolit të institucioneve supreme të auditimit për rritjen e përgjegjshmërisë në përdorimin e parasë publike, u organizua pjesëmarrja edhe në vizita studimore në selinë e Bankës Botërore në Washington DC si dhe në Komisionin për Mbikqyrje Publike në Kongresin Amerikan.

Në takimin në Bankën Botërore u prezantuan praktika të bashkëpunimit ndërmjet këtij institucioni dhe institucioneve supreme të auditimit në të gjithë botën me qëllim kontributin në misionin e përbashkët të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Gjithashtu u paraqitën prezantime nga përfaqësues të lartë të Bankës Botërore mbi zhvillimet më të fundit dhe sfidat në fushën e inteligjencës artificiale.

Në rolin e vëzhguesve, në Kongresin Amerikan, u mundësua pjesëmarrja në një seancë dëgjimore që Kontrollori i Përgjithshëm i GAO zhvilloi në Komisionin për Mbikqyrjen Publike, gjatë së cilës prezantoi një nga raportet e vitit të hartuar nga GAO dhe iu përgjigj pyetjeve të ndryshme që kongresmenë anëtarë të Komisionit kishin. Ky ishte një shembull shumë domethënës i përdorimit të punës së institucioneve supreme të auditimit për qëllime të vendimmarrjes nga ligjvënësit.



Në përfundim të pjesëmarrjes në këtë program, përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse të auditimit u pajisën me certifikatat përkatëse.